1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
  2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike..

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me

---

ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

#### **E. ANULIMI I PROCEDURËS**

#### **26. Anulimi i procedurës**

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon vendimin përfundimtar për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti/ Enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
  - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
  - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
  - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
  - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
  - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.
3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.
4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

---

## SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Formulari i Ofertës ekonomike, për procedurat e prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët nga operatori ekonomik

Shtojca 3: Listat e Çmimeve të artikujve

Shtojca 4: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 5: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Sasisë dhe Grafikut i lëvrimit

Shtojca 8: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

## Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

### FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE<sup>4</sup>

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontratës;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

<sup>4</sup> Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

---

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë _____</b>	

---

## Shtojca 2.

*[Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët, nga operatori ekonomik plotësohet dhe paraqitet vetëm kjo Shtojcë]*

### FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE<sup>5</sup>

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

c) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlere absolute është si më poshtë:

---

<sup>5</sup> Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

1	2	3
Nr.	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit e shprehur ne vlere absolute

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	

**Kujdes:** Bazuar në parashikimet e nenit 45/2.1 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, kur si kriter vlerësimi përdoret “oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët”, autoriteti/entë kontraktor përlogarit çmimin bazuar në:

- a) çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date
- b) elementet fiskale;
- c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës;

**Shtojca 3.**

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

**LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE**

**Data:** \_\_\_\_\_

**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**  
\_\_\_\_\_

**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë** (në rast BOE): \_\_\_\_\_

**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në këtë Formular duhet të plotësohen dhe t'u vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa vlerë do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	
<b>Artikulli</b>	<b>Përshkrimi i mallit</b>	<b>Sasia</b>	<b>çmimi per njësi</b>	<b>Çmimi total për artikull (3 x 4X)</b>	
1.					
2.					
3.					
4.					
5.					
	<b>Çmimi total (Mallrat)</b>				_____
<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>					
<b>TVSH (%)</b>					
<b>Çmimi total me TVSH:</b>					
<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>					
<b>Nënshkrimi</b>					

---

<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	

#### Shtojca 4.

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*  
*[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]*

### FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

\* \* \*

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi *(nëse zbatohet)*: Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së.*

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

*Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.*

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit/entit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

**[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]**

## Shtojca 5.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

### Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

### VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### Përfaqësuesi i Ofertuesit

### Nënshkrimi

### Vula

## Shtojca 6.

[ Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor ]

### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

**SHËNIM:** Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

## I. SPECIFIKIMET TEKNIKE

Në tabelën nr. paraqiten specifikimet teknike të kërkuara nga mjekët specialist:

Nr.	Artikulli	Specifikime teknike	Njesia
<b>PLLAKA</b>			
1	<b>Pllake klavikule (qe jane locking)</b>	Pllake klavikule tip locking ,e majte dhe e djathte per vida 3.5mm locking dhe me gjatesi 54-118 mm me deviacion +/-10%.	Copë
2	<b>Pllake tibiale auto-kompresive per vida 4.5mm</b>	Pllaka duhet te kete gjatesi nga 70 mm deri 295 mm me nje deviacion +/- 10%.	Copë
3	<b>Pllake Femuri auto-kompresive per vida 4.5mm</b>	Pllaka duhet te kete nje gjatesi e cila varion nga 118mm deri ne 330mm me nje deviacion +/- 10%.	Copë

4	<b>DHS/DCS</b>	Pllake DHS me kend 135 dhe me gjatesi 80-260 mm me devijacion +/- 10%. Pllake DCS me kend 95 dhe me gjatesi 115-260 mm me devijacion +/- 10%. Gjatesia e vides qendrore (Lag) 50- 110mm me devijacion +/- 10%. Gjatesia e vides kompresive 25mm.	Copë
5	<b>Pllake Radiusi dhe Ulnë per vida 3.5mm</b>	Te jete me gjatesi nga 62 mm deri ne 160 mm per vida 3.5mm me devijacion +/-10%.	Copë
6	<b>Pllake distale mediale tibiale locking</b>	Pllake distale mediale tibiale locking per vida 3.5, e majte dhe e djathte me gjatesi 128 deri ne 230 mm devijacion +/- 10%.	Copë
7	<b>Pllake rekonstruktive per vida 3.5 mm</b>	Pllaka duhet te jete ne variantin e drejte ose e harkuar me gjatesi 58 mm-215 mm me devijacion +/-10%.	Copë
8	<b>Pllake Proximale mediale dhe laterale locking Tibiale</b>	Pllaka proksimale mediale tibiale locking e majte dhe e djathte te jete me gjatesi 90 mm deri me 230 mm devijacion +/-10%. Pllaka proksimale laterale tibiale e maje dhe e djathe me gjatesi 100 mm deri me 220 mm me devijacion +/- 10%.	Copë
9	<b>Shtifte Femuri(Intramedullary Nail)</b>	Duhet te kene diameter nga 8 mm -13mm me te pakten 6 diametra. Gjatesi nga 330 mm deri ne 440 mm me devijacion +/- 10 %. Te jete I shoqeruar me vidat proksimale dhe distale sipas sistemit perkates.Te jete i shoqeruar dhe me tapen fundore.	Copë
10	<b>Shtifte Tibie (Intramedullary Nail)</b>	Duhet te kene diameter nga 8 mm-12 mm me te pakten 5 diametra dhe te kene gjatesi ,qe fillohet nga 280 mm deri ne 375 mm me devijacion +/- 10 %. Te jete i shoqeruar me vidat proksimale dhe distale sipas sistemit perkates Te jete i shoqeruar dhe me tapen fundore.	Copë

**Materialet e mesiperme duhet të jetë titan/titanium alloy**

**VIDA**

11	<b>Vida kortikale 3.5</b>	Vida kortikale 3.5mm me gjatesi nga 12 mm –50 mm me devijacion +/- 10%.	Copë
12	<b>Vida kortikale 4.5</b>	Vida kortikale 4.5mm me gjatesi nga 16 mm – 50 mm me devijacion +/- 10%.	Copë
13	<b>Vida spongiotike 4.0</b>	Vida spongiotike 4.0 mm me gjatesi nga 16mm – 60 mm me devijacion +/- 10%.	Copë
14	<b>Vida spongiotike 6.5</b>	Vida Spongiotike 6.5mm me gjatesi nga 30mm – 100mm me devijacion +/- 10%.	Copë
15	<b>Vida maleolare 4.0</b>	Vida maleolare 4.0 mm me gjatesi nga 35mm – 70mm me devijacion +/- 10%.	Copë

**Materialet e mesiperme duhet të jetë titan/titanium alloy**

**PROTEZA**

16	<b>Komponenti Femoral pa cement</b>	Stemi femoral pa cement duhet te kete te pakten 9 permasa me nje gjatesi 132 mm deri ne 175 mm me nje devijacion maksimal +/-10% dhe nje gjeresi diafizare nga 6 mm deri ne 20mm me nje devijacion maksimal +/- 10%; Komponenti femoral te kete perberje Titanium/ Titanium alloy,te kete te aplikuar plasma spray coating e cila siguron fiksimin afatgjate te komponentit me kocken dhe/ose cdo material tjeter ekuivalent i cili realizon funksionin per produktin e kerkuar,; Konusi i qafes duhet te jete 12/14 dhe stemi te kete nje kend cerviko-diafizar 125 ose 135 grade me nje deviacion +/- 10%. <b>Per te vertetuar permbushjen</b>	Copë
----	-------------------------------------	--	------

		<b>e ketyre specifikimeve teknike. OE duhet te paraqesin nga nje moster.</b>	
17	<b>Komponenti Femoral me cement</b>	Stemi femoral me cement duhet ,te kete perberje co-cr/co-cr alloy ose stain steel/stain steel alloy. Konusi i qafes te jete 12/14 dhe kendi cerviko diafizar te jete 125 ose 135 grade me nje deviacion +/- 10%. Stemi femoral duhet te kete te pakten 9 permasa me nje gjatesi 132mm deri ne 175 mm me nje devijacion maksimal +/-10% dhe nje gjeresi diafizare nga 6mm deri ne 20mm me nje deviacion +/-10%. <b>Per te vertetuar permbushjen e ketyre specifikimeve teknike. OE duhet te paraqesin nga nje moster.</b>	Copë
18	<b>Kokat Femorale</b>	Kokat Femorale te jene me perberje Co-Cr/Co-Cr alloy ose stain steel/stain steel alloy. Koni i brendshem te jete 12/14. Kokat femorale te jene me diameter 28mm me te pakten 4 permasa. <b>Per te vertetuar permbushjen e ketyre specifikimeve teknike. OE duhet te paraqesin nga nje moster</b>	Copë
19	<b>Koka Bipolare</b>	Koka bipolare duhet te jete e perbere nga pjesa metalike qe eshte ne kontakt me acetabulum dhe pjesa e insertit qe permban koken femorale.Pjesa metalike eshte e perbere nga materiali stainless steel/stainless steel alloy ose cdo material tjetër ekuivalent.Inserti duhet te jete polietilen me peshe molekulare te larte(UHMËPE).Permasat e pjeses metalike duhet te fillojne nga diametri 39 deri ne diametrin 55 me nje devijacion +/-10%. <b>Per te vertetuar permbushjen e ketyre specifikimeve teknike. OE duhet te paraqesin nga nje moster</b>	Copë
20	<b>Cementi Kockorë</b>	Cementi per kocken duhet te jete ne paketime nga 40g dhe te jete ne tre variantet: te kete ne perberje te tij nje antibiotik te tipit gentamicine, te kete ne perberje te tij dy antibiotik te tipit gentamicine dhe vancomycine, dhe pa antibiotik ne rast se pacienti eshte alergjik nga antibiotiku. Afati i skadences ti kaloje 1 (nje) vit. <b>Per te vertetuar permbushjen e ketyre specifikimeve teknike. OE duhet te paraqesin nga nje moster</b>	Copë
21	<b>Komponenti Femoral i Gjurit</b>	Komponenti femoral i gjurit duhet te ofrohet ne variantin CR dhe PS.Duhet te ofrohet ne variantin narroë dhe standart per te dy variantet CR dhe PS. Komponenti femoral duhet te jete i majte dhe i djathte per te dy tipet e varianteve(CR-PS,Narroë-Standart). Duhet te kete te pakten 10 permasa per secilen ane me devijacion +/-10%.. Siperfaqja e protezes te kete perberje Co-Cr/Co-Cr alloy ose titanium/titanium alloy. <b>Per te vertetuar permbushjen e ketyre specifikimeve teknike. OE duhet te paraqesin nga nje moster</b>	Copë
22	<b>Komponenti Tibial i Gjurit</b>	Komponenti tibial i gjurit duhet te jete I majte dhe I djathte. Duhet te kete te pakten 9 permasa per secilen ane me devijacion +/-10%..Siperfaqja e Protezes të ketë përbërje: Co-Cr/Co-Cr alloy ose titanium/ titanium alloy. <b>Per te vertetuar permbushjen e ketyre specifikimeve teknike. OE duhet te paraqesin nga nje moster</b>	Copë

23	<b>Polyethylene (Liner) i Gjurit</b>	Duhet te ofrohet ne variantin CR dhe PS.Duhet te jete i majte dhe i djathte si per variantin CR dhe variantin PS.Duhet te kete te pakten 7 permasa per secilen ane nga 10mm deri ne 18mm me devijacion +/-10%. <b>Per te vertetuar permbushjen e ketyre specifikimeve teknike. OE duhet te paraqesin nga nje moster</b>	Copë
<b>PLLAKA</b>			
24	<b>Pllake humeri proksimal (locking)</b>	Pllake proksimale humeri locking per vida 3.5mm ose4.00mm me gjatesi 90 mm- 220 mm deviacion +/-10%.	Copë
25	<b>Pllake femuri proksimal</b>	Pllake femuri proksimal locking te jete e majte dhe e djathte me nje gjatesi 160 mm deri ne 305 mm me nje deviacion +/- 10%.	Copë
26	<b>Pllake femuri distal</b>	Pllake femuri distal locking te jete e majte dhe e djathte me nje gjatesi 150 mm deri ne 295 mm me nje deviacion +/- 10%.	Copë
27	<b>Pllake 1/3 tubulare Locking</b>	Te kete gjatesi te ndryshme nga 40 mm deri ne 150mm me devijacion +/-10%.	Copë
28	<b>Pllaka locking distale radiale</b>	Pllake distale locking e majte e djathte per vida 2.5mm me gjatesi 46-62 mm me deviacion +/- 10%.	Copë
<b>Materiali i pllakave(art nr 24-28) duhet te jete titan/titanium alloy</b>			
<b>VIDA</b>			
29	<b>Vida locking 2.5 mm</b>	Vida locking 2.5 mm me gjatesi 10mm-34 mm me nje devijacion maksimal +/- 10%.	Copë
30	<b>Vida locking 3.5 mm</b>	Vida locking 3.5 mm me gjatesi 12mm-60mm me nje devijacion maksimal +/- 10%.	Copë
31	<b>Vida locking 4.0 mm</b>	Vida locking 4.0 mm me gjatesi 14 mm -60 mm me nje devijacion maksimal +/- 10%.	Copë
32	<b>Vida locking 6.5mm</b>	Vida locking 6.5 mm me gjatesi 30 mm -100 mm me nje deviajcion maksimal +/-10%	Copë
<b>Material i vidave(art nr 29-32) duhet te jete titan/titanium alloy</b>			
33	<b>Shtiza Kirschner</b>	Shtizat Kirschner duhet te kene diameter:1.0mm -1.2mm-1.4mm-1.6mm-1.8mm-2.0mm.Per cdo diameter duhet te kene gjatesi nga 150 mm deri ne 330mm me nje devijacion +/-10% me te pakten 5 gjatesi.	Copë
34	<b>Shtiza Steinman</b>	Shtiza Steinman te jene ne tre permasa ne diameter 4.0mm, 4.5mm e 5.0mm e gjatesi nga 220 mm ne 250 mm me nje devijacion +/- 10%.	Copë
35	<b>Tel per sinteze(cerclage ëire)</b>	Te jete me diameter nga 0.4 deri ne 1.5 me nje devijacion +/- 10%.	Rulo
36	<b>Ankora titanium/titanium alloy</b>	Ankora te jete me age dhe pa age me diameter 2 mm deri ne 6.5 mm me te pakten 5 permasa, me devijacion + - 10%.	Copë

**Shënim 1:** Data e skadencës (për ato mallra që kanë afat skadence) e mallrave, në ditën e lëvrimit të mallit, duhet të jetë jo më pak se ½ e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës/ose/jo më pak se 1(një) vit nga data e lëvrimit të mallit.

**Shënim 2:** Per për çdo operacion që do të kryhet operatori fitues do të vërë në dispozicion, nje set montimi dhe të paktën një specialist të trajnuar për përdorimin e seteve.

---

Specifikimet teknike te vendosura nga ana e AK, shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara

Transporti/montimi dhe vendosja e mallrave objekt prokurimi në ambjentet e përcaktuara nga Spitali Rajonal Lezhe do të realizohet nga operatori ekonomik fitues.

## Shtojca 7.

## FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

## Sasia e mallit që kërkohet:

Nr.	Artikulli	Specifikime teknike	Njesia	Sasia për një periudhë 24 mujore
<b>PLLAKA</b>				
1	Pllake klavikule (qe jane locking)	Pllake klavikule tip locking ,e majte dhe e djathte per vida 3.5mm locking dhe me gjatesi 54-118 mm me deviacion +/-10%.	Copë	10
2	Pllake tibiale auto-kompresive per vida 4.5mm	Pllaka duhet te kete gjatesi nga 70 mm deri 295 mm me nje deviacion +/- 10%.	Copë	15
3	Pllake Femuri auto-kompresive per vida 4.5mm	Pllaka duhet te kete nje gjatesi e cila varion nga 118mm deri ne 330mm me nje deviacion +/- 10%.	Copë	10
4	DHS/DCS	Pllake DHS me kend 135 dhe me gjatesi 80-260 mm me devijacion +- 10%. Pllake DCS me kend 95 dhe me gjatesi 115-260 mm me devijacion +- 10%. Gjatesia e vides qendrore (Lag) 50- 110mm me devijacion +- 10%. Gjatesia e vides kompresive 25mm.	Copë	15
5	Pllake Radiusi dhe Ulne per vida 3.5mm	Te jete me gjatesi nga 62 mm deri ne 160 mm per vida 3.5mm me devijacion +/-10%.	Copë	10
6	Pllake distale mediale tibiale locking	Pllake distale mediale tibiale locking per vida 3.5, e majte dhe e djathte me gjatesi 128 deri ne 230 mm devijacion +/-10%.	Copë	20
7	Pllake rekonstruktive per vida 3.5 mm	Pllaka duhet te jete ne variantin e drejte ose e harkuar me gjatesi 58 mm-215 mm me devijacion +/-10%.	Copë	5
8	Pllake Proximale mediale dhe laterale locking Tibiale	Pllaka proksimale mediale tibiale locking e majte dhe e djathte te jete me gjatesi 90 mm deri me 230 mm devijacion +/-10%. Pllaka proksimale laterale tibiale e maje dhe e djathe me gjatesi 100 mm deri me 220 mm me devijacion +/- 10%.	Copë	10
9	Shtifte Femuri(Intramedullary Nail)	Duhet te kene diameter nga 8 mm -13mm me te pakten 6 diametra. Gjatesi nga 330 mm deri ne 440 mm me devijacion +/- 10 %. Te jete I shoqeruar me vidat proksimale dhe distale sipas sistemit perkates.Te jete i shoqeruar dhe me tapen fundore.	Copë	10
10	Shtifte Tibie (Intramedullary Nail)	Duhet te kene diameter nga 8 mm-12 mm me te pakten 5 diametra dhe te kene gjatesi ,qe fillohet nga 280 mm deri ne 375 mm me devijacion +/- 10 %. Te jete i shoqeruar me vidat proksimale dhe distale sipas sistemit perkates Te jete i shoqeruar dhe me tapen fundore.	Copë	10
Materialet e mesiperme duhet të jetë titan/titanium alloy				
<b>VIDA</b>				

11	Vida kortikale 3.5	Vida kortikale 3.5mm me gjatesi nga 12 mm –50 mm me devijacion +/- 10%.	Copë	500
12	Vida kortikale 4.5	Vida kortikale 4.5mm me gjatesi nga 16 mm – 50 mm me devijacion +/- 10%.	Copë	500
13	Vida spongiotike 4.0	Vida spongiotike 4.0 mm me gjatesi nga 16mm – 60 mm me devijacion +/- 10%.	Copë	200
14	Vida spongiotike 6.5	Vida Spongiotike 6.5mm me gjatesi nga 30mm – 100mm me devijacion +/- 10%.	Copë	200
15	Vida maleolare 4.0	Vida maleolare 4.0 mm me gjatesi nga 35mm – 70mm me devijacion +/- 10%.	Copë	25
Materialet e mesiperme duhet të jetë titan/titanium alloy				
PROTEZA				
16	Komponenti Femoral pa cement	Stemi femoral pa cement duhet te kete te pakten 9 permasa me nje gjatesi 132 mm deri ne 175 mm me nje devijacion maksimal +/-10% dhe nje gjeresi diafizare nga 6 mm deri ne 20mm me nje devijacion maksimal +/- 10%; Komponenti femoral te kete perberje Titanium/ Titanium alloy,te kete te aplikuar plasma spray coating e cila siguron fiksimin afatgjate te komponentit me kocken dhe/ose cdo material tjetër ekuivalent i cili realizon funksionin per produktin e kerkuar,; Konusi i qafes duhet te jete 12/14 dhe stemi te kete nje kend cerviko-diafizar 125 ose 135 grade me nje deviacion +/- 10%.	Copë	15
17	Komponenti Femoral me cement	Stemi femoral me cement duhet, te kete perberje co-cr/co-cr alloy ose stain steel/stain steel alloy. Konusi i qafes te jete 12/14 dhe kendi cerviko diafizar te jete 125 ose 135 grade me nje deviacion +/- 10%. Stemi femoral duhet te kete te pakten 9 permasa me nje gjatesi 132mm deri ne 175 mm me nje devijacion maksimal +/-10% dhe nje gjeresi diafizare nga 6mm deri ne 20mm me nje deviacion +/-10%.	Copë	40
18	Kokat Femorale	Kokat Femorale te jene me perberje Co-Cr/Co-Cr alloy ose stain steel/stain steel alloy. Koni i brendshem te jete 12/14. Kokat femorale te jene me diameter 28mm me te pakten 4 permasa.	Copë	55
19	Koka Bipolare	Koka bipolare duhet te jete e perbere nga pjesa metalike qe eshte ne kontakt me acetabulum dhe pjesa e insertit qe permban koken femorale.Pjesa metalike eshte e perbere nga materiali stainless steel/stainless steel alloy ose cdo material tjetër ekuivalent.Inserti duhet te jete polietilen me peshe molekulare te larte(UHMWPE).Permasat e pjeses metalike duhet te fillojne nga diametri 39 deri ne diametrin 55 me nje devijacion +/-10%.	Copë	55

20	Cementi Kockorë	Cementi per kocken duhet te jete ne paketime nga 40g dhe te jete ne tre variantet: te kete ne perberje te tij nje antibiotik te tipit gentamicine, te kete ne perberje te tij dy antibiotik te tipit gentamicine dhe vancomycine, dhe pa antibiotik ne rast se pacienti eshte alergjik nga antibiotiku. Afati i skadences ti kaloje 1 (nje) vit.	Copë	50
21	Komponenti Femoral i Gjurit	Komponenti femoral i gjurit duhet te ofrohet ne variantin CR dhe PS. Duhet te ofrohet ne variantin narrow dhe standart per te dy variantet CR dhe PS. Komponenti femoral duhet te jete i majte dhe i djathte per te dy tipet e varianteve (CR-PS, Narrow-Standard). Duhet te kete te pakten 10 permasa per secilen ane me devijacion +/-10%. Siperfaqja e protezes te kete perberje Co-Cr/Co-Cr alloy ose titanium/titanium alloy.	Copë	2
22	Komponenti Tibial i Gjurit	Komponenti tibial i gjurit duhet te jete I majte dhe I djathte. Duhet te kete te pakten 9 permasa per secilen ane me devijacion +/-10%.Siperfaqja e Protezes të ketë përbërje: Co-Cr/Co-Cr alloy ose titanium/ titanium alloy.	Copë	2
23	Polyethylene (Liner) i Gjurit	Duhet te ofrohet ne variantin CR dhe PS.Duhet te jete i majte dhe i djathte si per variantin CR dhe variantin PS.Duhet te kete te pakten 7 permasa per secilen ane nga 10mm deri ne 18mm me devijacion +/-10%.	Copë	2
<b>PLLAKA</b>				
24	Pllake humeri proksimal (locking)	Pllake proksimale humeri locking per vida 3.5mm ose4.00mm me gjatesi 90 mm- 220 mm deviacion +/-10%.	Copë	10
25	Pllake femuri proksimal	Pllake femuri proksimal locking te jete e majte dhe e djathte me nje gjatesi 160 mm deri ne 305 mm me nje deviacion +/- 10%.	Copë	15
26	Pllake femuri distal	Pllake femuri distal locking te jete e majte dhe e djathte me nje gjatesi 150 mm deri ne 295 mm me nje deviacion +/- 10%.	Copë	10
27	Pllake 1/3 tubulare Locking	Te kete gjatesi te ndryshme nga 40 mm deri ne 150mm me devijacion +/-10%.	Copë	30
28	Pllaka locking distale radiale	Pllake distale locking e majte e djathte per vida 2.5mm me gjatesi 46-62 mm me deviacion +/- 10%.	Copë	15
<b>Materiali i pllakave (art nr 24-28) duhet te jete titan/titanium alloy</b>				
<b>VIDA</b>				
29	Vida locking 2.5 mm	Vida locking 2.5 mm me gjatesi 10mm-34 mm me nje devijacion maksimal +/- 10%.	Copë	30
30	Vida locking 3.5 mm	Vida locking 3.5 mm me gjatesi 12mm-60mm me nje devijacion maksimal +/- 10%.	Copë	50

31	Vida locking 4.0 mm	Vida locking 4.0 mm me gjatesi 14 mm -60 mm me nje devijacion maksimal +/- 10%.	Copë	30
32	Vida locking 6.5mm	Vida locking 6.5 mm me gjatesi 30 mm -100 mm me nje deviajcion maksimal +/-10%	Copë	30
Material i vidave(art nr 29-32) duhet te jete titan/titanium alloy				
33	Shtiza Kirschner	Shtizat Kirschner duhet te kene diameter:1.0mm - 1.2mm-1.4mm-1.6mm-1.8mm-2.0mm.Per cdo diameter duhet te kene gjatesi nga 150 mm deri ne 330mm me nje devijacion +/-10% me te pakten 5 gjatesi.	Copë	200
34	Shtiza Steinman	Shtiza Steinman te jene ne tre permasa ne diameter 4.0mm, 4.5mm e 5.0mm e gjatesi nga 220 mm ne 250 mm me nje devijacion +/- 10%.	Copë	30
35	Tel per sinteze(cerclage wire)	Te jete me diameter nga 0.4 deri ne 1.5 me nje devijacion +/- 10%.	Rulo	20
36	Ankora titanium/titanium alloy	Ankora te jete me age dhe pa age me diameter 2 mm deri ne 6.5 mm me te pakten 5 permasa, me devijacion + - 10%.	Copë	10

**Shënim 1:** Data e skadencës (për ato mallra që kanë afat skadence) e mallrave, në ditën e lëvrimit të mallit, duhet të jetë jo më pak se ½ e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës/ose/jo më pak se 1(një) vit nga data e lëvrimit të mallit.

**Shënim 2:** Per për çdo operacion që do të kryhet operatori fitues do të vërë në dispozicion, nje set montimi dhe të paktën një specialist të trajnuar për përdorimin e seteve.

Specifikimet teknike te vendosura nga ana jone, shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara

Transporti/montimi dhe vendosja e mallrave objekt prokurimi në ambjentet e përcaktuara nga Spitali Rajonal Lezhe do të realizohet nga operatori ekonomik fitues.

**Afati i lëvrimit:** Brenda 4 (katër) muajve nga data e nënshkrimit të minikontratës.

---

## Shtojca 8.

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

##### OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, oseqë ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera,

Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

---

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

#### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

1. Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit**. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2023, 2024, 2025) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese.*

*Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

#### **2.3 Kapaciteti teknik:**

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën

---

**jo më pak se 20 % e vlerës së fondit limit.** Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
  - b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
2. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatë të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:
- **ISO 9001 “Mbi Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë” ose ekuivalente** (të vlefshme në datën e zhvillimit të tenderit), në përputhje me objektin e prokurimit;
  - **Certifikatë ISO 9001/ ose/ ekuivalent ISO 13485 “Mbi Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë” /ose ekuivalent/ të vlefshme, për prodhuesit e artikujve të ofruar, ose në rastin kur OE ofertues nuk është prodhues të paraqesë Vetëdeklarim ku të deklarojë se furnizuesi është konform Standardeve të Cilësisë.**
3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikata konformiteti CE ose FDA **ose ekuivalente / të barasvlefshme** me to për artikujt e ofruar, të vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës.
4. Operatori duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi i mallrave ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi, ku në rast të dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin, për lejimin e tregëtimit të artikujve objekt prokurimi.
5. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogë teknikë / skedë teknike për të gjithë artikujt objekt prokurimi ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike të kërkuara. Në katalog duhet të tregohen dhe të markohen qartë karakteristikat teknike të artikujve të ofruara, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria e tyre me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentat standarte të tenderit, të përcaktuara në Shtojcën 6 të DST-së.
6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim të vlefshëm për tregëtim të pajisjeve mjeksore të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë sipas ligjit 89/2014 datë 17.07.2014 “Për pajisjet mjeksore”.
7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë **ofertën teknike**, për artikujt objekt prokurimi sipas numrit rëndor në Shtojcën 3 “Lista e çmimeve të artikujve” në formë table, ku të

---

pasqyrohet: Emërtimi i artikullit, Specifikimet teknike, Emri i kompanisë prodhuese, Origjina e mallit, Emërtimi i katalogut të artikullit / produktit, Nr. e faqes ku ndodhet produkti, si dhe çertifikimet përkatëse për produktin.

8. Operatori ekonomik ofertues, duhet të paraqesë **deklaratë se do të mundësojë praninë e një tekniku të trajnuar për setet e montimit (minimumi 1 set montimi,) për çdo operacion që do të kryhet.** Setet e montimit dhe aksesoret përkatëse do të ofrohen në përdorim sipas protokollit të operacionit nga Operatori Ekonomik fitues deri në përfundimin e kontratës.

Për teknikun e trajnuar duhet të paraqitet **Çertifikatë / Dëshmi** e lëshuar nga kompanitë prodhuese të seteve që të provojnë trajnimet e tij si dhe **kontratë pune / kontratë shërbimi.**

**Shënim:** Kriteri si më sipër konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 9. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

9. Operatori ekonomik, në datën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit duhet të paraqesë nga një mostër për artikujt me Nr. Rendor **16, 17, 18, 19, 20, 21, 22** dhe **23**, në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara. Dorëzimi i mostrave, të bëhet pranë Operatorit të Blerjeve të Përqendruara SHA në adresën: *Rruga “Reshit Collaku”, Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë)*, të mbyllura në një zarf /kuti jo transparente të vulosur mbi të cilin të shënohet:

- “Mos e hapni me përjashtim të rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të procedurës së prokurimit “*Blerje materiale Ortopedike për Spitalin Rajonal Lezhë*” dhe jo para datës **11.05.2026, ora 11:00** (\*Data e hapjes/dorëzimit të Ofertave).
- Se bashku me mostrat ofertuesi duhet të japë edhe një shkresë të vulosur dhe firmosur ku të listohen mostrat që ndodhen në zarf/kuti.
- Mbi çdo mostër të dorëzuar, ofertuesi duhet të shënoje Nr. Rëndor të Artikullit që përfaqëson sipas formularit të çmimit.
- Në paketimin e çdo mostre duhet të evidentohet qartë origjina e mallit, e cila duhet të përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi.

10. Operatori ekonomik ofertues, duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë **shërbimin e transportit** të artikujve objekt prokurimi në adresën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor përfitues.

11. Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë ku të shprehet se do të vendosë në dispozicion të AK çertifikatat e regjistrimit të mallit pranë institucioneve përkatëse në RSH (sipas ligjit 89/2014 “Për pajisjet mjekësore).

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## Shtojca 9.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

### FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

#### A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

#### B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:			
• Informacione për nënkontraktorin			
Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

<b>Emri (at) e subjekteve</b>	<b>NIPT-i</b>	<b>Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik</b>	<b>Specifiko konkretisht kapacitetin/et</b>

## **Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit**

### **A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT**

<b>Deklarata</b>
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
